



**ODA E INXHINIERËVE
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

SHARRCEM SH.P.K.
FABRIKA PER PRODHIMIN E ÇIMENTOS
Nr. =255=
Data 30.07.2025
HANI ELEZIT



**TITAN
SHARRCEM**

Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës Komora inženjera Republike Kosovo Chamber of Engineers of the Republic of Kosovo	
Njësia org. Org. Jedinica Org. Unit	Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No.
Nr. i faqeve Br. Stranica Nr. Pages	Data: Datum: Date:
<u>018x</u>	<u>647/25</u>
<u>✓</u>	<u>31.07.25</u>
PRISHTINË / A No.1	

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI / MEMORANDUM OF UNDERSTANDING

I LIDHUR NDËRMJET / BETWEEN

**ODA E INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS / ENGINEERING CHMABER OF THE
REPUBLIC OF KOSOVO**

DHE / AND

TITAN/SHARRCEM

Në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-012 "Për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit", Statutin e Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës dhe duke u bazuar në misionin zhvillimor dhe rregullativ të OIRK-së, si dhe në përkushtimin e kompanisë SHARRCEM për mbështetje të profesionit të inxhinierisë, zhvillimit të qëndrueshëm, mbrojtjes së ambientit dhe Shëndetit dhe Sigurisë në punë, palët e mëposhtme:

Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës (OIRK)

Adresa: Kompleksi Rilindja, Kontejneri nr. 3, Kati 2, 10000 Prishtinë

E përfaqësuar nga Kryetari, Z. **Arsim Rapuca**

dhe

TITAN/SHARRCEM SH.P.K.

Adresë: Rr. Adem Jashari, nr. 280, Hani I Elezit

E përfaqësuar nga Drejtori Menaxhues, Z. **Behar Disha**

Bien dakord të lidhin këtë Marrëveshje Mirëkuptimi si më poshtë:

Neni 1. Qëllimi i Marrëveshjes

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është të krijojë një kornizë bashkëpunimi profesional ndërmjet OIRK dhe SHARRCEM, me synim përparimin e profesionit të inxhinierisë në Kosovë, zhvillimin e qëndrueshëm dhe përkrahjen e edukimit të vazhdueshëm profesional.

Neni 2. Fushat e Bashkëpunimit

Palët pajtohen të bashkëpunojnë në fushat e mëposhtme:

In accordance with Law No. 08/L-012 "On Chambers of Architects and Engineers in the Field of Construction", the Statute of the Chamber of Engineers of the Republic of Kosovo and based on the developmental and regulatory mission of the ECRK, as well as on the commitment of SHARRCEM company to support the engineering profession, sustainable development, environmental protection and Occupational Health and Safety, the following parties:

ENGINEERS CHAMBER OF REPUBLIC OF KOSOVA (ECRK)

Address: Kompleksi Rilindja, office no. 3, floor 2, 10000, Prishtinë

Represented by the President, Mr. **Arsim Rapuca**

and

TITAN/SHARRCEM SH.P.K.

Address: Rr. Adem Jashari, no. 280, Hani I Elezit

Represented by Country Manager, Mr. **Behar Disha**

Agree to enter into this Memorandum of Understanding as follows:

Article 1. Purpose of the Agreement

The purpose of this agreement is to create a framework for professional cooperation between ECRK and SHARRCEM, aiming at the advancement of the engineering profession in Kosovo, sustainable development and support for continuing professional education.

Article 2. Areas of Cooperation

The Parties agree to cooperate in the following areas:

1. **Praktika profesionale** – SHARRCEM angazhohet të ofrojë mundësi për zhvillimin e praktikës profesionale për inxhinierët praktikantë të regjistruar në OIRK, në përputhje me Rregulloren për Regjistrimin, të Drejtat dhe Detyrimet e Praktikantëve të OIRK, nën mbikëqyrjen e një inxhinieri të licencuar, anëtar i rregullt i Odës;
2. **Edukimi i vazhdueshëm profesional** – Palët do të bashkëpunojnë në organizimin e trajnimeve, seminareve, punëtorive dhe aktiviteteve të tjera që kontribuojnë në zhvillimin profesional të inxhinierëve. SHARRCEM do të mbështesë OIRK-në në këto aktivitete përmes përfshirjes së trajnerëve të saj profesionalë, ekspertëve teknikë dhe infrastrukturës që ka në dispozicion. Të gjitha aktivitetet do të jenë në përputhje me Rregulloren për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional dhe do të akreditohen me pikë EVP nga OIRK;
3. **Shkëmbimi i njohurive teknike** – Bashkëpunim në hartimin dhe publikimin e dokumenteve teknike, analizave, standardeve dhe udhëzimeve profesionale që ndihmojnë avancimin e fushës së ndërtimit;
4. **Pjesëmarrje dhe përfaqësim** – OIRK ka të drejtë të caktojë përfaqësues të saj në çdo aktivitet teknik, publik ose mediatik të përbashkët me SHARRCEM;
5. **Etika profesionale dhe përdorimi i identitetit institucional** - Palët zotohen të respektojnë parimet e etikës profesionale në të gjitha aktivitetet e përbashkëta. Asnjëra palë nuk ka të drejtë të përdorë emrin, logon apo përfaqësimin vizual të palës tjetër në materiale promovuese, mediatike apo institucionale pa pëlqimin paraprak me shkrim të palës përkatëse;

1. **Professional Internship** – SHARRCEM is committed to providing opportunities for the development of professional internship for practicing engineers registered in ECRK, in accordance with the Regulation on Registration, Rights and Obligations of Interns of ECRK, under the supervision of a licensed engineer, a regular member of the Chamber;
2. **Continuous professional education** – The Parties will cooperate in organizing trainings, seminars, workshops and other activities that contribute to the professional development of engineers. SHARRCEM will support ECRK in these activities through the involvement of its professional trainers, technical experts and the infrastructure at its disposal. All activities will be in accordance with the Regulation on Continuing Professional Education and will be accredited with EVP points by ECRK;
3. **Exchange of technical knowledge** – Cooperation in the drafting and publication of technical documents, analyses, standards and professional guidelines that help advance the field of construction;
4. **Participation and representation** – ECRK has the right to appoint its representatives in any technical, public or media activity jointly with SHARRCEM;
5. **Professional ethics and use of institutional identity** – The Parties undertake to respect the principles of professional ethics in all joint activities. Neither party has the right to use the name, logo or visual representation of the other party in promotional, media or institutional materials without the prior written consent of the respective party;

6. **Përkrahje në politikat publike** – Bashkëpunim në hartimin e rekomandimeve profesionale, dokumenteve analitike dhe pjesëmarrje në zhvillimin e politikave publike që ndikojnë sektorin e ndërtimit;

7. **Mbështetje në zhvillimet ligjore dhe profesionale** - Palët zotohen të ofrojnë përkrahje të ndërsjellë profesionale në proceset ligjore dhe rregullative që prekin fushën e ndërtimit, përmes këshillave teknike, pjesëmarrjes në tryeza profesionale dhe ofrimit të ekspertizës, me qëllim avancimin e standardeve dhe përmirësimin e politikave publike;

8. **Raportimi dhe transparenca** – OIRK do të raportojë në Kuvendin e saj aktivitetet që dalin nga kjo marrëveshje, për të siguruar transparencë institucionale.

Neni 3. Koordinimi dhe Zbatimi

Palët do të caktojnë nga një person kontaktues për zbatimin dhe koordinimin e aktiviteteve të përbashkëta. Çdo ndryshim i personit përgjegjës do të njoftohet me shkrim.

Neni 4. Marrëveshjet Zbatuese

Aktivitetet konkrete që dalin nga kjo marrëveshje do të përshkruhen në Marrëveshje Zbatuese të veçanta, të cilat do të nënshkruhen para fillimit të çdo aktiviteti përkatës.

Neni 5. Të Drejtat Pronësore dhe Konfidencialiteti

Të gjitha informacionet dhe materialet e ndara mes palëve do të ruhen si konfidenciale. Të drejtat e autorit dhe pronësisë intelektuale mbi materialet origjinale mbesin të palës që i ka krijuar. Materialet e krijuara bashkërisht do të jenë në bashkëpronësi.

Neni 6. Dispozita Financiare

Kjo marrëveshje nuk krijon obligime financiare për asnjërën palë. Çdo aktivitet konkret që kërkon përfshirje financiare do të rregullohet veçmas me marrëveshje të posaçme.

6. **Support in public policies** – Cooperation in the drafting of professional recommendations, analytical documents and participation in the development of public policies that affect the construction sector;

7. **Support in legal and professional developments** – The parties commit to provide mutual professional support in legal and regulatory processes affecting the construction sector, through technical advice, participation in professional round tables and provision of expertise, with the aim of advancing standards and improving public policies;

8. **Reporting and transparency** – ECRK will report to its Assembly on the activities arising from this agreement, to ensure institutional transparency.

Article 3. Coordination and Implementation

The Parties shall each designate a contact person for the implementation and coordination of joint activities. Any change of the responsible person shall be notified in writing.

Article 4. Implementing Agreements

The concrete activities arising from this agreement will be described in separate Implementing Agreements, which will be signed prior to the start of each relevant activity.

Article 5. Property Rights and Confidentiality

All information and materials shared between the parties will be kept confidential. Copyright and intellectual property rights in the original materials remain with the party that created them. Jointly created materials will be jointly owned.

Article 6. Financial Provisions

This agreement does not create financial obligations for either party. Any specific activity requiring financial involvement will be regulated separately by special agreement.

Neni 7. Zgjidhja e Mospajtimeve

Çdo mosmarrëveshje që mund të lind nga kjo marrëveshje do të zgjidhet nëpërmjet marrëveshjes së ndërsjellë ndërmjet palëve.

Neni 8. Kohëzgjatja dhe Ndryshimet

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe mbetet në fuqi për një periudhë tre (3) vjeçare. Ajo mund të ndryshohet ose plotësohet me marrëveshje të ndërsjellë me shkrim. Çdo palë mund të tërhiqet nga marrëveshja me njoftim të shkruar 30 ditë përpara.

Neni 9. Dispozita Përfundimtare

Kjo marrëveshje është përgatitur në katër (4) kopje identike, nga të cilat dy (2) mbesin në OIRK dhe dy (2) në SHARRCEM.

Neni 10. Monitorimi dhe Vlerësimi i Zbatimit

Palët pajtohen që të organizojnë takime të përbashkëta, së paku një herë në vit, për të vlerësuar zbatimin e kësaj marrëveshjeje, për të identifikuar sfidat dhe për të propozuar masa për përmirësim. Për çdo aktivitet të realizuar në kuadër të kësaj marrëveshjeje, do të mbahet dokumentacion përkatës dhe do të përgatitet raport i shkurtër i zbatimit.

Article 7. Dispute Resolution

Any dispute that may arise from this agreement shall be resolved through mutual agreement between the parties.

Article 8. Duration and Amendments

This agreement shall enter into force on the date of signature and shall remain in force for a period of three (3) years. It may be amended or supplemented by mutual agreement in writing. Either party may withdraw from the agreement by giving 30 days' prior written notice.

Article 9. Final Provisions

This agreement is prepared in four (4) identical copies, of which two (2) shall remain with ECRK and two (2) with SHARRCEM.

Article 10. Monitoring and Evaluation of Implementation

The parties agree to organize joint meetings, at least once a year, to evaluate the implementation of this agreement, to identify challenges and to propose measures for improvement. For each activity carried out within the framework of this agreement, relevant documentation shall be maintained and a brief implementation report shall be prepared.

ENGINEERS CHAMBER OF REPUBLIC OF KOSOVA

ARSIM RAPUCA

President



Data: 30 Korrik 2025

TITAN/SHARRCEM

BEHAR DISHA

Country Manager



Date: 30 July 2025